

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E ARSIMIT**

Nr i Prokurimit **208 Udheheqesi-25-3150-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NNP"CTA"shpk&"U - UNIQUE" SH. P. K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr.Mehmet Gradica hy2 nr6

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383-44-507719

(Numri Telefonit)

(Numri)

ZIJA MORINA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nnpcta@gmail.com

(Adresa elektronike)

28.10.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: : **Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë**
Njoftimi për kontratë është bërë me datën **12.06.2025** dhe hapja publike është bërë me datën **06.10.2025**. Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me procesin e vlerësimit është publikuar me datë 17.10.2025 ndërsa edhe njoftimin për tenderusin e pasukseshëm na është dërguar me datën 17.10.2025. Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja eshte bere ne platformën e prokurimi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datën 17.10.2025 kam kekruar qasje ne doskumenta zyrtar AK po ne te njeten dite me dokon sqarim se qasja nuk mund te lejohet sepse OE ka plotesuar dokumentet si sekret afarist dhe s edokumentet qe nuk jan esekret afarist do ju dergoj ne email me dat e20.10.2025 ne ora 7-38 mengjes i kam kerkuar prape rikujtes per qasje AK nuk eshte pergjigjuar ne pasdite i kam dergu Ne ora 13-55 te dates 20.10.2025 ju kam drejtuar me emakl zyrtarit te prokurimit Xhemajl Buzuku me kerkesen e nejt qe te me lejohet qasja ai ne ora 15-16min me dorgon ne email ket dokumentacion te oe te shpallur fitues duke u arsyetur prap si sekret afariste.

Me date 20.10.2025 ora 20-19 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim per njoftimin per dhenje te kontrates nga AK. AK ka shqyrtuar kërkesën tonë dhe me datën 24.10.2025 na ka dërguar vendimin lidhur me këtë shqyrtim ku sipas këtij vendimi AK ka hedhur poshtë pretendimet tona dhe ka lënë në fuqi njoftimin per dhenje te kontrates te datës 17.10.2025 . Në përputhje me LPP-në dhe brenda afatit ligjor ne i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë kundër vendimit të AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar me përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Përpos kësaj AK nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit të cilat vetë i ka parashtruar në fillim të këtij procesi të prokurimit. Dispozitat që ne mendojmë se AK i ka shkelur janë:

***NENI 10 i LPP-së -4/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

***NENI 11 i LPP-së -4/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

***NENI 60 i LPP-së -4/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

***NENI 61 i LPP-së-4/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

***NENI 69 i LPP-së -4/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

*Neni 7.6 i Rregullores Nr. 002/2024 të KRPP-
--

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Letra standarte per tenderuesin e pasuksesshëm me date 17.10.2025

Njoftimi mbi Vendimin e AK –Titulli i kontrates se dhene nga AK kompanise
GOE WORLD MEDIUM DHE NNP ATC COM SHPK si pale e paknaqur kemi kerku
qasje me date 17.10.2025 ne e-prokurim ora 14-40



Nga OE :

NNP CTA SHPK

Lënda:Kerkese per qasje ne dokumenta zyrtar

OE NNP NNP CTAshpk kërkon qasje ne dokumnta zyrtar lidhur me
tenderin me titull :

Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë me nrp 208 Udheheqesi-25-3150-5-1-1

Prishtinë: 17.10.2025

Drejtori :idn ZIJA MORINA



Po ne te njejten date 17.10.2025 AK na dergon ne e-prokurimi ne ora 15-45 min dite e premtë se qasja ju lejohet vetem me dergim te dokumenteve ne email sepse OE i shpallur fitues ka paraqitur sekret afarist dokumentacionin e tenderit .



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology*
NJOFTIM PËR QASJE NË DOKUMENTA

Të nderuar,

Pasi që nuk po skanohen mire dokumentat dhe nuk po shihen po ju dergoj edhe njehere njoftimin

Ju shkruaj në lidhje me kërkesën tuaj për qasje në dokumenta publike, lidhur me lëndën:
Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë

Të bashkangjitur gjeni kërkesën për qasje në dokumentacionin për tenderin Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë: **Grup i Operatorëve Ekonomik NNP CTA SH.P.K.; U - UNIQUE SH.P.K., RR. MEHMET GRADICA, HY.2, NR.6, 10000, PRISHTINË**; me Nr. të prokurimit: 208 Udheheqesi-25-3150-5-1-1 me numer të mbrendshën ; 208 025 030 511

Mbështetur në Ligjin e Prokurimit Publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), sipas kërkesës së drejtuar tek Autoriteti Kontraktues, ju siguron qasje të arsyeshme. si palë të interesuar, kanë qasje në dokumentet e tenderit, përveç atyre dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete afariste nga Operatorët Ekonomikë dhe të pranuar si të tilla nga Autoriteti Kontraktues.

Ju lejohet qasja në dokumenta sipas nenit 11 të Ligjit të Prokurimit Publik, duke përjashtuar informatat sekrete afariste që janë kërkuar nga Operatorët Ekonomikë dhe që do të klasifikohen nga Autoriteti Kontraktues.

Dokumentat i dergojm me Email te cilat nuk kan sekret afarist.

Data: 17.10.2025

Emri dhe mbiemri i ZPP-së:
Xhemajl Buzuku

Me date 20.10.2025 ne ora 7-38 pasi që AK nuk ka caktu daten kohen oren per qasje prap kam kekruar per her te dyte që te me mundesohet qasja me kete shkrese

KËRKESË / KUJTESË URGJENTE PËR CAKTIMIN E DATËS DHE ORËS SË QASJES NË DOKUMENTE

Nga:

Operatori Ekonomik: NNP CTA SH.P.K.

Lënda: Kujtesë dhe plotësim i kërkesës për qasje në dokumente publike –

Tenderi: “Ndërtimi i Çerdhës në Kalabri, Prishtinë”

Nr. i prokurimit: 208 Udheheqësi-25-3150-5-1-1 / Nr. i brendshëm: 208 025 030 511

I. RRETHANAT E REJA

Me datë **17.10.2025**, Autoriteti Kontraktues ka dërguar njoftim për qasje në dokumente, por:

1. Publikimi është bërë **ditën e premte pasdite**, në mënyrë që **të pamundësohet qasja gjatë fundjavës (18-19 tetor 2025)**;
2. Në njoftim **nuk është specifikuar** se cilat dokumente janë cilësuar si “sekret afërist” dhe cilat janë të hapura për qasje-te markuara nga OE i shpallur fitues+ankesi3;
3. **Nuk është caktuar data, koha apo ora** e saktë për realizimin e qasjes në sistemin e-prokurim;
4. Deri më **20.10.2025**, Operatorit Ekonomik **ende nuk i është bërë e ditur** as data dhe as ora e qasjes së lejuar, gjë që **pengon ushtrimin e të drejtës ligjore për verifikim** të dokumenteve të tenderit dhe zbaton praktikisht kufizim të qasjes.

II. KËRKESA KONKRETE

Në bazë të:

- Neneve 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik;
- Nenit 7.6 të Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik;

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues menjëherë të:

1. **Caktojë dhe komunikojë me shkrim datën, orën dhe mënyrën e qasjes zyrtare** në dokumente dhe në sistemin e-prokurimit;
2. **Specifikojë qartë** cilat dokumente janë cilësuar si “sekret afërist” dhe cilat janë të hapura, duke treguar bazën ligjore për secilin rast;
3. Të lejojë qasje të menjëhershme në dokumentet jo-sekrete, në përputhje me nenin 11 të LPP-së;
4. Të përgatisë **procesverbalin e qasjes** me shënimin e dokumenteve të hapura dhe të kufizuara.

III. VËREJTJE LIGJORE

Mosveprimi brenda afatit të arsyeshëm përbën shkelje të nenit 11 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe kufizim të paarsyeshëm të transparencës.

Në rast të mosrespektimit, **Operatori Ekonomik do të ushtrojë të drejtën ligjore të ankesës** në KRPP dhe OSHP, për shkelje të procedurave të qasjes dhe për vonesë të qëllimshme në publikim.

Prishtinë, më 20.10.2025

Përfaqësuesi i OE:

Zija Morina

Drejtor – NNP CTA SH.P.K.

A handwritten signature in blue ink is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text "KOMARJA NDERTIMORE PROJEKTIM", "NNP CTA SH.P.K.", "shërbime të inxhinierisë dhe arkitektures", and "Prishtinë".

Ne ora 13-55 te dates 20.10.2025 ju kam drejtuat me emakl zyrtarit te prokurimit Xhemajl Buzuku me kerkesen e nejt qe te me lejohet qasja ai ne ora 15-16min me dorgon ne emajl ket dokumentacion te oe te shpallur fitues duke u arsyetur me kte tekst

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës suaj për qasje në dokumentet e dosjeve të Operatorëve Ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, ju njoftojmë se:

Në përputhje me **Ligjin e Prokurimit Publik**, qasja në dokumentacionin e ofertuesve është **lejuar**, përveç dokumentvër te cilat përmbajnë **informata konfidenciale dhe/ose sekret afarist**, siç përcaktohet me ligj.

Dokumentet qe nuk jan secret afarist I keni ne email

Faleminderit për mirëkuptim.

10/20/25, 4:39 PM

Gmail - FW:



Nnp Cta <nnpcta@gmail.com>

FW:

Xhemajl Buzuku <Xhemajl.Buzuku@rks-gov.net>
To: Nnp Cta <nnpcta@gmail.com>

Mon, Oct 20, 2025 at 3:16 PM

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës suaj për qasje në dokumentet e dosjeve të Operatorëve Ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, ju njoftojmë se:

Në përputhje me **Ligjin e Prokurimit Publik**, qasja në dokumentacionin e ofertuesve është **lejuar**, përveç dokumentvër te cilat përmbajnë **informata konfidenciale dhe/ose sekret afarist**, siç përcaktohet me ligj.

Dokumentet qe nuk jan secret afarist I keni ne email

Faleminderit për mirëkuptim.

 **E tërë oferta - 2025-10-20T150629.011 - Copy.zip**
14748K

E tërë oferta - 2025-10-20T150629.011 - Copy.zip 3 items

Name	Last modified	File size
 1. Deklarata nen betim, konzorciumi, sigurimi.rar	-	-
 2. Certifikata e biznesit, e tvsh-se.rar	-	-
 a3f4c9ec-1efa-4fb8-9565-9e80f13d1ad9.pdf	-	-

Pretendimi nr 1

Pas dergimit te emailit mu pamundesua qasja dhe ne afat ligjor I drejtohem AK ne kerkese per rishqyrtim:

1. Objekti i kërkesës

Kjo kërkesë për rishqyrtim parashtrohet në përputhje me **Nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, me qëllim të **rishqyrtimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues** për kufizimin e qasjes në dokumentet e tenderit me titull: **“Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë”**, me nr. të prokurimit **208 Udheheqesi-25-3150-5-1-1**.

2. Shkeljet e pretenduara

1. **Moslejimi i qasjes së plotë** në dokumentacionin e ofertuesit fitues, duke dërguar vetëm **tri dokumente** me email (Certifikatën e biznesit dhe dy deklarata nën betim me aneksin 3).
2. **Mungesa e caktimit të datës, orës dhe mënyrës zyrtare të qasjes** në sistemin e e-prokurimit, në kundërshtim me nenin 7.6 të Rregullores Nr.002/2024 të KRPP-së.
3. **Klasifikimi i përgjithshëm i dosjes si “sekret afarist”**, pa ndarje të qartë të dokumenteve sipas natyrës ligjore dhe pa arsyetim për secilin rast.
4. **Shkelja e parimit të transparencës dhe barazisë**, duke mos mundësuar verifikimin e ofertës fituese nga operatorët tjerë ekonomikë.

3. Bazat ligjore

Kërkesa mbështetet në dispozitat e mëposhtme:

- **Neni 10 dhe 11** i Ligjit Nr. 04/L-042 – parimi i transparencës dhe e drejta e qasjes në dokumente publike;
- **Neni 60** – përcakton mënyrën e **vlerësimit të ofertave** dhe detyrimin e AK-së për respektimin e kriterëve ligjore;
- **Neni 61** – kërkon **njoftim të arsyetuar dhe qasje të plotë** për operatorët;
- **Neni 69** – përcakton **dokumentet e kualifikimit teknik e profesional**, të cilat janë publike;
- **Neni 7.6** i Rregullores Nr. 002/2024 të KRPP-së – **detyrimi për caktimin e datës, orës dhe mënyrës së qasjes**.

Këto dispozita garantojnë të drejtën për **qasjen efektive dhe transparente** në dokumente dhe kontroll ligjor të procesit të prokurimit.

4. Tabela ligjore për klasifikimin e dokumenteve sipas karakterit të sekretit afarist

Nr	Lloji i dokumentit / dëshmisë	Përbën sekret afarist?	Arsye dhe interpretim ligjor	Baza ligjore
1	Deklaratat tatimore, bilancet financiare, raportet e auditimit, qarkullimi bankar	✓ Po	Të dhëna ekonomike të ndjeshme që reflektojnë gjendjen e brendshme të kompanisë.	LPP: Neni 11.3, 68.3; Rreg.002/2024: Neni 7.6.3
2	Diplomat, licencat profesionale dhe nostrifikimet	✗ Jo	Dokumente publike të kualifikimit profesional.	LPP: Neni 69.1, 69.6.3; Rreg.002/2024: Neni 7.6.2
3	Vendimet për emërimin e menaxherit të projektit dhe stafit profesional	✗ Jo	Kritere të kualifikimit teknik; për transparencë.	LPP: Neni 69.6.3; Rreg.002/2024: Neni 7.6.2
4	CV-të e stafit profesional	⚠ Pjesërisht	Të dhënat profesionale janë publike; personale (ID, paga) fshihen.	LPP: Neni 11.4; Rreg.002/2024: Neni 7.6.3
5	Kontratat apo para-kontratat e punës	⚠ Pjesërisht	Marrëdhënia e punës është publike; paga dhe ID të mbrojtura.	LPP: Neni 11.4; Rreg.002/2024: Neni 7.6.3
6	Lista e punëtorëve dhe certifikatat e trajnimeve	⚠ Pjesërisht	Certifikatat publike; të dhënat personale të mbrojtura.	LPP: Neni 69.6.3; Rreg.002/2024: Neni 7.6.3
7	Raporti i vlerësimit të riskut nga kompani e licencuar MPMS	✗ Jo	Dokument teknik për siguri në punë.	LPP: Neni 69.5; Rreg.002/2024: Neni 7.6.2
8	Lista e projekteve të përfunduara dhe raportet e pranimit teknik	✗ Jo	Kontrata publike në e-prokurim; pa çmime.	LPP: Neni 11, 64; Rreg.002/2024: Neni 7.6.2
9	Makineritë, pajisjet dhe dëshmitë e pronësisë/qirasë	✗ Jo	Kapacitete teknike publike të kualifikimit.	LPP: Neni 69.6.3; Rreg.002/2024: Neni 7.6.2
10	Certifikatat ISO, dokumentet e cilësisë dhe sigurimit teknik	✗ Jo	Dokumente standarde të cilësisë.	LPP: Neni 69.5; Rreg.002/2024: Neni 7.6.2
11	Çmimet, analizat e kostos, ofertat financiare	✓ Po	Informata tregtare të ndjeshme; strukturë çmimesh.	LPP: Neni 11.3; Rreg.002/2024: Neni 7.6.3
12	Kontratat publike me autoritete shtetërore	✗ Jo	Të regjistruara në e-prokurim.	LPP: Neni 64; Rreg.002/2024: Neni 7.6.2

13	Letra referencë dhe konfirmime nga punëdhënësi publikë	✗ Jo	Përvojë profesionale, jo tregtare.	LPP: Neni 69.6; Rreg.002/2024: Neni 7.6.2
14	Raportet teknike të përfundimit të punimeve, inspektimet dhe verifikimet	✗ Jo	Dokumente të verifikueshme publikisht.	LPP: Neni 64; Rreg.002/2024: Neni 7.6.2

5. Kërkesa konkrete ndaj AK-së

Bazuar në nenet e sipërpërmendura, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të:

1. **Rishqyrtojë vendimin** për kufizimin e qasjes në dokumente dhe të lejojë **qasjen e plotë në dokumentet jo-sekrete afariste**, sipas tabelës së mësipërme;
2. **Caktojë datën, orën dhe mënyrën zyrtare** të qasjes në sistemin e e-prokurimit dhe të njoftojë palën me shkrim;
3. **Përcaktojë qartë** cilat dokumente janë trajtuar si “sekret afarist” dhe bazën ligjore për secilin rast;
4. **Përgatisë procesverbalin e qasjes**, me listën e dokumenteve të hapura dhe të kufizuara;
5. **Të sigurojë respektimin e plotë të parimeve të transparencës dhe trajtimit të barabartë** të operatorëve ekonomikë;
6. **Të bëjë filtrimin dhe kategorizimin e dokumenteve të ofertës fituese**, duke ndarë qartë ato që janë “sekret afarist” nga ato që janë dokumente publike, në përputhje me nenin 11 të LPP-së dhe nenin 7.6.3 të Rregullores 002/2024;
7. **Të mundësojë qasje të drejtpërdrejtë në sistemin e e-prokurimit**, në mënyrë që të verifikohet nëse dokumentet janë shënuar si “sekret afarist” dhe të garantohet se kufizimet janë bërë në përputhje me ligjin.

AK pas kërkeses për rishqyrtim na degjon vendimin mbi refuzimin e kërkeses son si te pabazuar:



213-1061	DALJE	24.10.25
2		

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Prosvete, Nauke,
Tehnologije i Inovacija - Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

DATE/A	22.10.2025
REFERENCE:	MASHITI/ZP
PËR/ZA/TO:	NNP CTA SHPK
CC:	znj. Fadile Dyla, sekretare e përgjithshme
Përmes:	Arkivit
NGA/OD/FROM:	Xhemajl Buzuku, zyrtarë përgjegjës për prokurim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 20.10.2025 e parashtruar nga Operatori Ekonomik NNP CTA SHPK., lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë, me nr. të prokurimit: 208 Udheqyesi-25-3150-5-1-1, kundër B58 NJOFTIM PËR VENDIMIN E AK - MASHITI nxjerrë këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: NNP CTA SHPK.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 108 dhe nenit 111 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, si dhe në përputhje me Rregullat dhe Udhëzimet Operative të Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të plotë dhe të hollësishëm të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik NNP CTA SHPK., lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë, ka arritur në këto konstatime:

Pas analizimit të të gjitha pretendimeve të parashtruara nga operatori ekonomik ankuës, si dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë të aktivitetit të prokurimit në fjalë, Autoriteti Kontraktues konstaton se:

Në bazë të saj më sipër, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimet ank more të operatorit ekonomik NNP CTA SHPK. janë të pabazuara, dhe rrjedhimisht:

Në lidhje me kërkesën tuaj për qasje në dokumentet zyrtare të aktivitetit të prokurimit, ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues e ka shqyrtuar kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike,

AK, sqaron se OI: i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar kërkesen për sekret afarist dhe i ka dokumentet me sekret afarist të markuara.

Pas kërkesës për qasje janë dërguar me email të gjitha dokumentet që nuk përmbajnë informata konfidenciale apo sekret afarist.

Refuzohet ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik **NNP CTA SHPK** si e pabazuar.

Mbetet në fuqi vendimi i mëparshëm i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Ne si AK, ju falënderojmë për pjesëmarrjen në këtë tender, dhe ju inkurajojmë që të merrni pjesë dhe të ofertoni në këtë tenderë.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda (10) ditëve pas këtij vendimi.

Vendimi dorëzohet:

1. **NNP CTA SHPK** -Prishtinë.
2. 1x1 Arkivit të MASIT-it

I. Përshkrimi i shkurtër i rastit

Operatori ekonomik ankues NNP “CTA” SH.P.K., në bashkëpunim me U-UNIQUE SH.P.K., më datë 20.10.2025 ka dorëzuar kërkesë për **rishqyrtim të vendimit të Autoritetit Kontraktues**, duke kërkuar **qasjen në dokumentet e ofertës fituese** të operatorëve ATC COM SH.P.K. dhe N.N.SH. WORLD MEDIUM.

Më 22.10.2025, MASHTI ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se dokumentet janë klasifikuar si “sekret afarist”, në përputhje me nenin 11 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP).

Operatori ankues konsideron se vendimi i MASHTI-t është **i pabazuar ligjërisht dhe i padrejtë**, pasi kërkesat për sekret afarist janë **formulare standarde, pa individualizim dokumentesh, pa verifikim teknik në e-Prokurim, dhe pa lejuar qasje për verifikim nga operatori ankues**.

II. Bazat ligjore të ankesës

- Nenet 10, 11, 68, 69, dhe 108–111 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik;
- Nenet 7.5, 7.6, dhe 7.7 të Rregullores Nr. 002/2024 të KRPP-së;
- Parimet e **transparencës, barazisë, dhe konkurrencës së ndershme** (neni 6 i LPP-së).

III. Arsyetimi i ankesës

1 Kërkesat për sekret afarist janë të përgjithshme dhe pa specifikim dokumentesh

Operatorët ATC COM SH.P.K. dhe WORLD MEDIUM kanë dorëzuar kërkesa të njëjta për sekret afarist, duke pretenduar se **kapaciteti ekonomik, financiar, teknik dhe profesional** është konfidencial.

Në asnjë rast nuk është identifikuar **asnjë dokument konkret** si sekret afarist, siç kërkon **neni 11.3 i LPP-së dhe neni 7.6 i Rregullores 002/2024**.

➡ Kërkesat janë të përgjithshme dhe të pavlefshme juridikisht.

2 Nuk është lejuar qasja për verifikim të markimit në sistemin e e-Prokurimit

Operatorit ankues **nuk i është lejuar qasja për të verifikuar** nëse dokumentet e grupit të operatorëve fitues janë **të markuara si “sekrete afariste”** në sistemin elektronik të prokurimit.

Sipas **nenit 7.5 të Rregullores Nr. 002/2024**, çdo dokument që trajtohet si sekret afarist duhet:

- të jetë i **markuar në mënyrë elektronike** në e-Prokurim;
- të shoqërohet me **Aneksin 3 – Kërkesë për Sekret Afarist** të nënshkruar dhe të arsyetuar;
- dhe AK duhet të **verifikojë markimin përpara se të kufizojë qasjen**.

Pa këtë verifikim, **asnjë kërkesë për sekret afarist nuk mund të pranohet**.

➔ **Kufizimi i qasjes pa verifikim të markimit në e-Prokurim është i papranueshëm dhe i kundërligjshëm.**

3 Mungesë e provës për dëm material apo komercial

Të dy operatorët kanë dhënë arsye të përgjithshme (“mund të dëmtohet konkurrenca”), pa prova konkrete për dëm material.

➔ Sipas **nenit 11.3 (ii) të LPP-së**, kërkesa duhet të përmbajë **arsyetim dhe provë të qartë të dëmit**, çka mungon.

4 Përfshirja e dokumenteve publike si “sekrete afariste”

Operatorët kanë përfshirë në kërkesat e tyre dokumente publike si licencat, referencat, certifikatat ISO dhe kontratat e mëparshme etj.

➔ Këto dokumente janë **pronë publike**, të verifikueshme dhe **nuk mund të klasifikohen si sekrete afariste**, sipas **nenit 11.4 të LPP-së**.

5 Shkelje e parimit të transparencës dhe të drejtës për qasje

Autoriteti Kontraktues ka refuzuar qasjen pa ndarje të dokumenteve publike nga ato sekrete, dhe pa caktuar datë/orë zyrtare për konsultim, siç kërkon **neni 7.6.4 i Rregullores 002/2024**.

➔ Kjo përbën shkelje të **parimeve të transparencës dhe konkurrencës së ndershme**.

6 Mungesë e ndarjes ligjore të dokumenteve (Publike / Sekret afarist)

Autoriteti Kontraktues **nuk ka bërë ndarjen ligjore** të dokumenteve të ofertës sipas karakterit të tyre, siç kërkon **neni 11 i LPP-së** dhe **neni 7.6 i Rregullores 002/2024**.

Në mbështetje të kësaj, bashkëngjitet **Aneksi 1 – Ndarja e dokumenteve sipas karakterit**

të tyre ligjor, ku dëshmohej se **pjesa më e madhe e dokumenteve janë publike** dhe nuk përmbajnë elemente sekrete afariste.

ANEKSI 1 – Ndarja e dokumenteve sipas karakterit të tyre (Publike / Sekret afarist)

Nr.	Përshkrimi i dokumentit	Karakteri ligjor	Arsyeja ligjore dhe arsyetimi
1	Njoftimi për kontratë, dosja e tenderit, specifikimet teknike	Publike	Publikohen sipas nenit 40 të LPP; nuk përmbajnë të dhëna tregtare
2	Procesverbali i hapjes së ofertave	Publik	Neni 52 i LPP; dokument zyrtar që tregon ofertat dhe çmimet
3	Vendimi për vlerësim dhe raporti i rekomandimit për fituesin	Publik	Kërkohet nga neni 11(4) LPP për transparencë
4	Oferta financiare (çmimet për njësi, totali, afatet)	Publike	Neni 11(4) LPP: çmimet janë publike dhe nuk mbulohen si sekrete
5	Sigurimi i ofertës	Publik	Dokument formal pa element tregtar
6	Certifikata e biznesit / NIPT / regjistrimi në ARBK	Publik	Dokument i regjistruar publikisht
7	Deklarata nën betim	Publik	Dokument formal që nuk përmban informacione tregtare
8	Deklarata për formimin e konsorciumit	Publik	Tregon përbërjen juridike; nuk ka elemente tregtare
9	Referencat, certifikatat ISO, diplomat, kontratat e mëparshme	Publike	Përdoren për kualifikim profesional; të verifikueshme publikisht
10	Dokumentet që dëshmojnë përvojën e stafit teknik	Publike	Nuk përmbajnë sekrete tregtare
11	Analizat e kostos së brendshme / llogaritjet e çmimit	Sekret afarist	Zbulimi dëmton pozitën konkurruese
12	Raportet financiare / ekstraktet bankare	Sekret afarist	Përmbajnë të dhëna ekonomike të ndjeshme
13	Lista e furnitorëve, nën-kontraktorëve dhe marrëveshjet tregtare	Sekret afarist	Informacion i brendshëm tregtar
14	Teknologjitë specifike, metodat e punës dhe organizimi i brendshëm	Sekret afarist	Pjesë e know-how teknik të OE-së
15	Struktura e stafit me shpërblime / bonuse / kontrata pune	Sekret afarist	Informacion personal dhe financiar i brendshëm

IV. Përfundime

- 1** Kërkesat për sekret afarist janë të pavlefshme dhe të paarsyetuara ligjërisht;
- 2** Nuk ekziston verifikim i markimit të dokumenteve në e-Prokurim;
- 3** Operatorit ankues nuk i është lejuar qasja për ta verifikuar këtë fakt;
- 4** AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 dhe 11 të LPP-së dhe nenin 7.5 të Rregullores 002/2024;
- 5** Kjo ka cenuar transparencën dhe të drejtën për qasje ligjore në dokumentet e tenderit.

ARSYETIMI LIGJOR DHE PRAKTIKA E OSHP-së

1. Rrethanat dhe veprimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues (AK) ka refuzuar të më japë qasje në dokumentet e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, duke i klasifikuar ato në mënyrë të përgjithshme si “sekret afarist”.

Në përgjigjen zyrtare me email, AK ka dërguar vetëm: **deklaratën nën betim, Aneksin 3, sigurimin dhe certifikatën e biznesit**, ndërsa **të gjitha dokumentet tjera** – përfshirë kontratat, referencat, makineritë, dokumentet e stafit, diplomat, certifikatat dhe CV-të – janë cilësuar si “sekret afarist”.

Një klasifikim i tillë i përgjithshëm është në kundërshtim me **nenin 10 dhe 11 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)** dhe me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

2. Dispozitat ligjore të shkelura

Sipas **nenit 10 të LPP-së**, AK është i obliguar të sigurojë **transparencë, barazi dhe konkurrencë të ndershme** gjatë gjithë procedurës së prokurimit.

Neni 11.3 i LPP-së parasheh se dokumentet mund të klasifikohen si “sekret afarist” vetëm nëse:

- 1** nuk janë publike,
- 2** mbrohen nga zbulimi i paautorizuar, dhe
- 3** publikimi i tyre do të shkaktonte dëm material interesave komerciale të operatorit.

Çdo klasifikim duhet të jetë **i arsyetuar për secilin dokument** dhe të bazohet në kriterë konkrete.

Sipas **nenit 11.4 të LPP-së**, AK është i detyruar të përgatisë **versione të pastruara të dokumenteve**, duke hequr vetëm pjesët që realisht përmbajnë informata të mbrojtura.

Në mungesë të një analize të tillë, refuzimi i qasjes përbën shkelje të rëndë të ligjit dhe cenon **të drejtën për mbrojtje efektive** të operatorëve ekonomikë.

3. Qëndrimet dhe praktikat e konsoliduara të OSHP-së

Vendimi OSHP nr. 2024/1286

OSHP ka konstatuar se AK kishte kufizuar padrejtësisht qasjen në dokumente, pa kryer analizë për secilin dokument, gjë që përbën **shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP-së**.

“Klasifikimi i dokumenteve si sekrete afariste pa analizë të bazuar dhe pa përgatitje të versioneve të pastruara kufizon padrejtësisht qasjen e operatorëve ekonomikë në dokumente, duke cenuar transparencën dhe barazinë.”

Raporti i Ekspertit Shqyrtues (rasti 1286/2024)

Eksperti thekson se AK nuk ka bërë analizë për të vërtetuar nëse dokumentet përmbanin informata të mbrojtura.

“Moslejimi i qasjes në dokumente ka kufizuar padrejtësisht të drejtën e ankuesit dhe ka vendosur operatorët në pozitë të pabarabartë, në kundërshtim me parimin e transparencës dhe konkurrencës së ndershme.”

Vendimi OSHP nr. 2024/0860

“Dokumentet që dëshmojnë përvojën e mëparshme dhe kontratat e realizuara nuk mund të konsiderohen sekrete afariste, pasi ato janë pjesë e kualifikimit profesional dhe duhet të jenë të verifikueshme nga operatorët e tjerë për transparencë.”

Vendimi OSHP nr. 2023/1117

“Qasja në dokumentet që lidhen me përvojën dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë është pjesë thelbësore e garancisë për konkurrencë të ndershme dhe transparencë në vlerësim.”

Vendimi OSHP nr. 2023/0517

“Refuzimi total i qasjes në dokumente është i papranueshëm. Autoriteti Kontraktues duhet të lejojë qasje të pjesshme përmes redaktimit të pjesëve që përmbajnë të dhëna personale ose komerciale të ndjeshme.”

Vendimi OSHP nr. 2024/1229

“Sekretet afariste nuk mund të përdoren si arsyetim për fshehje të plotë të dokumenteve. Klasifikimi i përgjithshëm pa analizë përbën shkelje të nenit 11 të LPP-së.”

Vendimi OSHP nr. 2024/0521

“Klasifikimi si ‘sekret afarist’ pranohet vetëm nëse Autoriteti Kontraktues ka bërë analizë të dokumentuar që dëshmon përmbushjen e kushteve të nenit 11.3 dhe neneve 68–69 të LPP-së.”

4. Çfarë nuk është sekret afarist

Bazuar në nenet 68–69 të LPP-së dhe në praktikën e OSHP-së:

Nuk janë sekret afarist këto dokumente:

- Kontratat e realizuara dhe referencat e punës;
- Listat e makinerisë dhe pajisjeve;
- Dokumentet e stafit profesional dhe teknik;
- Diplomat, certifikatat dhe licencat profesionale;
- CV-të e stafit dhe dëshmitë e përvojës së mëparshme;
- Dokumentet e kualifikimit profesional dhe kapacitetit teknik.

Këto dokumente janë pjesë përbërëse e dosjes së tenderit dhe shërbejnë për vërtetimin e kapaciteteve profesionale e teknike të operatorëve ekonomikë. Ato **janë të nevojshme për vlerësim të drejtë dhe për transparencë**, prandaj nuk mund të konsiderohen sekrete afariste.

Sekret afarist mund të jenë vetëm:

- analizat e kostos së brendshme,
- strukturat e çmimeve,
- lista e furnitorëve,
- planet teknologjike ose të prodhimit, dhe
- të dhënat e brendshme financiare që mund të dëmtojnë interesin komercial të operatorit.

5. Përfundim dhe kërkesë

Në përputhje me nenet **10, 11, 68 dhe 69 të LPP-së**, si dhe me praktikën e qëndrueshme të OSHP-së në vendimet e mësipërme, kërkohet që:

- 1 Të konstatohet** se Autoriteti Kontraktues ka shkëlur parimet e transparencës dhe barazisë, duke kufizuar padrejtësisht qasjen në dokumentet e operatorit fitues;
- 2 Të urdhërohet AK-ja** të përgatisë version të pastruar të dokumenteve, duke hequr vetëm pjesët që përmbajnë të dhëna realisht sekrete afariste;
- 3 Të lejohet qasje e pjesshme** në dokumentet që dëshmojnë përvojën, kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit;
- 4 Të kthehet procedura në rivlerësim**, duke garantuar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

6. Përfundim përfundimtar

“Kontratat, referencat e punës, listat e makinerisë dhe pajisjeve, dokumentet e stafit profesional dhe teknik, diplomat, certifikatat, licencat, CV-të dhe dokumentet e përvojës së mëparshme nuk përbëjnë ‘sekret afarist’ në kuptim të neneve 68 dhe 69 të LPP-së.

Këto dokumente janë të domosdoshme për transparencë dhe verifikim të ligjshmërisë së procedurës së prokurimit publik.

Klasifikimi i tyre i përgjithshëm si i tillë, pa analizë ligjore dhe pa version të pastruar të dokumenteve, është **shkelje e qartë e nenit 10 dhe 11 të LPP-së**, si dhe bie ndesh me praktikën e qëndrueshme të OSHP-së (vendimet nr. 2024/1286, 2024/0860, 2023/1117, 2024/1229, 2023/0517 dhe 2024/0521).

Prandaj, kërkohet që OSHP të konstatojë shkeljen dhe të urdhërojë AK-në të sigurojë qasje të plotë ose të pjesshme në këto dokumente, duke garantuar transparencë dhe barazi në procedurë.”

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e G OE NNP’’CTA’’shpk&’’U - UNIQUE’’ SH. P. K. lidhur me tenderin **Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë** me nrp: **208 Udheheqesi-25-3150-5-1-1**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e **Ndërtimi i Çerdhes në Kalabri, Prishtinë** dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM**.

Te Urdhërohet Autoritetit Kontraktues që të bëjë lejinin **verifikimin teknik** të markimit në sistemin e e-Prokurimit;

Lejimin e qasjes së plotë në dokumentet që nuk janë sekret afarist;

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, shpenzime përgatitore në aspektin teknik për kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, dhe me një përvojë të madhe në fushën e ndërtimeve.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ne i kemi bashkangjitur Ankesës tonë dokumentet e renditura më poshtë:

- Një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”
- Një kopje të publikimit për “Njoftimi mbi Vendimin e AK”
-

Vërejtje: Të gjitha pretendimet tona mbështeten me fakte që i gjeni të bashkangjitura kësaj ankese por edhe në dokumentacionin e AK

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*